



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.985/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti dhe Arsim Hamzaj - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.M. nga fshati “.....”, Komuna e Pejës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V. K. K., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF-Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura I. sh.p.k me seli në Prishtinë, av L.B., për shkak të kompensimit të pagave jubilarë dhe pagave për përcjellje për në pension, duke vendosur sipas ankesave së paditëses dhe ankesës së të paditurës, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4488/19, të datës 27.10.2020, pas mbajtjes së seancës së kolegjit, me datë **06.12.2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET në tërësi e themeltë ankesa e paditëses R. M. nga fshati “.....”, Komuna e Pejës, **NDRYSHOHET** aktgjyqimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4488/19, i datës 27.10.2020, në pikën IV të dispozitivit dhe gjykohet si vijon: **APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses R. M., **DETYROHET** e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF-Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të tri pagave jubilarë t’ia paguajë shumën prej 1.121,49 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjyqimit të shkallës së parë 27.10.2020, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjyqimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF-Prishtinë, ndërsa aktgjyqimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4488/19, i datës 27.10.2020, në pikën I, II dhe III të dispozitivit **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjyqimin e ankimuar C.nr.4488/19, të datës 27.10.2020, ka vendosur si në vijim:

“I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses R. M. nga fshati ‘.....’ Komuna e Pejës.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, QKMF Prishtinë, që paditëses R. M. në emër të shpërblimit për tre paga përcjellëse me rastin e daljes në pension t’ia paguajë shumën prej 1.121,49 Euro (njëmijë e njëqind e njëzetë e një euro e dyzet e nëntë cent), me kamatë ligjore 8%, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. DETYROHET e paditura që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 30.00 (tridhjetë) Euro.

IV. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses si e pabazuar, mbi shumën e gjykuar për tre paga jubilarë, në shumën 1.121,49 Euro (njëmijë e njëqind e njëzetë e një euro e dyzet e nëntë cent).

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor, ankesa kanë paraqitur e autorizuara e paditëses dhe i autorizuarit i të paditurës, dhe atë e autorizuara e paditëses vetëm sa i përket pikës IV të dispozitivit dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar aktgjykimi i atakuar të ndryshohet në pikën IV të dispozitivit ndërsa kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar.

I autorizuari i të paditurës aktgjykimin e ka atakuar sa i përket pikës I, II dhe III të dispozitivit dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar në këto pika të prishet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar.

Përgjigje në ankesa nuk janë paraqitur nga të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e paditëses është e **themeltë**, ndërsa ankesa e të paditurës është e **pathemeltë**.*

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësja R. M., përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 13.12.2019 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QKMF-Prishtinë, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të kompensimit të tri pagave jubilarë dhe tri pagave për përcjellje për në pension t’ia paguajë shumën përgjithshme prej 2.240.64 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë e

deri në pagesën definitive. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita kur aktgjykimi ta marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E paditura, sikurse në përgjigje në padi, ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.4488/19, të datës 27.10.2020, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se mes palëve ndërgjyqëse nuk kanë qenë kontestuese fakti se paditësja ka qenë e punësuar tek e paditura, deri në momentin kur me vendimin e datës 20.11.2019, i ndërprehet marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, prova këto të administruara në këtë shqyrtim, mirëpo kontestuese nga ana e të paditurës ishte se e paditura nuk ka obligim dhe nuk ka linjë të veçantë buxhetore për kryerjen e këtij obligimi, e po ashtu e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes lidhur me pagat për përcjellje për në pension vendimin e saj e ka bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë nenit 17 paragrafi 5, ku parashihet e drejta për realizimin e pagave për përcjellje për në pension dhe meqenëse paditësja ka qenë punëtore e të paditurës dhe me vendimin nr.2906, të datës 23.10.2019, paditëses përfundimisht i ndërprehet marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, e njëjta ka të drejtën e realizimit të këtyre pagave. Lartësinë e kërkesëpadisë për pagat përcjellëse gjykata e ka vërtetuar në bazë të listës së pagave për pagat e realizuara për tre muajt e fundit nga e cila është vërtetuar se paditësja ka pranuar pagë mujore në shumë prej 373.44 Euro.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se sa i përket pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë së paditëses që i referohet kërkesës për kompensimin e tri pagave jubilarë, gjykata ka arsyetuar se pala paditëse nuk i ka sjellë prova gjykatës lidhur me lartësinë e stazhit të punës i cili është paraparë si kusht i domosdoshëm për realizimin e pagave jubilarë andaj edhe mbi këtë bazë e ka bërë refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses për kompensimin e tri pagave jubilarë. Vendimin mbi kamatën e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimin lidhur me shpenzime procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e të autorizuarës së paditëses dhe ankesën e të autorizuarit të paditurës brenda kufijve të tyre por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b),

g), j), k) dhe m) si dhe për zbatimin e së drejtës materiale vjen në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i vëren gjykata sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera që pretendohet me ankesë, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për pagesën e tri pagave jubilarë dhe për këtë gjë u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se me dispozitën e nenit 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “ *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*”. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “ *Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”.

Me nenin 17 paragraf 3, të Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë të datës 11.06.2018 përcaktohet se: “ *Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë 3.1. për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij, 3.2. për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij, 3.3. për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij* ”, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni, përcaktohet se: “ *Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf*”.

Gjykata e Apelit vëren se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ia ka refuzuar kërkesëpadinë paditëses përkitazi me pagesën e tri pagave jubilarë. Kjo për faktin se ajo pasi ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe ka vërtetuar faktet të cilat ishin vendimtare për çështjen kontestuese ajo në vend se të aprovonte kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit edhe për tri paga jubilarë, për shkak se paditësja ka përvojë pune mbi 30 vite e cila vërtetohet nga Libreza e punës nr.173686, me çka rrjedhimisht edhe të njëjtës i takon kompensimi për pagesën e tri pagave jubilarë, dhe se e njëjta mbështetet në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018, të lidhur dhe nënshkruar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSHSK-së) dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 11.06.2018 dhe se e njëjta ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditëses me datë 20.11.2019, e duke pasur parasysh faktin se paditësja ka mbi 30 vite përvojë pune, me çka edhe një mënyrë e tillë e vendosjes nga ana e gjykatës ankimore është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të

Punës dhe 17 paragrafi 3 dhe 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018, andaj edhe aktgjykimi i atakuar u ndryshuar duke iu njohur e drejta paditëse për kompensimin e tri pagave jubilarë.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të autorizuarit të paditurës se aktgjykimi në pjesën e vërtetuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësja për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension me datë 20.11.2019, dhe se i njëjta ka përvojë pune mbi 30 vite. Përveç kësaj nuk ka qenë kontestuese as lartësia e pagave.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë për arsyeje se: Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*. Me dispozitën e nenit 17 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive Sektoriale përcaktohet se: *“ Kompensimi në rast të pensionimit i punësuarit me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tre (3) paga mujore, që i ka marrë për tre (3) muajt e fundit”*.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje të plotë me dispozitën nga neni 382 paragraf 1 dhe 2 i LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë

arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.985/2021, datë 06.12.2021

**Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka**